



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:093617
Datë: 29.05.2024
Numri i dokumentit: 05752894

C.nr.1709/23

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtaren Rajmonda Kurteshi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.M., nga Komuna P., të cilin e përfaqëson Q.M., avokate në P., kundër të paditurit H.A., nga Komuna P., të cilin e përfaqëson S.M., avokat në Pejë, baza juridike vërtetim i të drejtës së pronësisë, duke vendosur lidhur me lejueshmërinë e marrëveshjes së lidhur në mes të palëve ndërgjyqës në procedurën e Ndërmjetësimit, jashtë seance me datën 29.05.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET MARRËVESHJA JASHTËGJYQËSORE, me numër të lëndës Nd.nr.../24 e arritur në Qendrën për Ndërmjetësim në Pejë, me datën 27.02.2024, e lidhur në mes A.M., nga Komuna P., të cilin e përfaqëson Q.M., avokate në P., kundër të paditurit H.A., nga Komuna P., të cilin e përfaqëson S.M., avokat në Pejë, baza juridike vërtetim i të drejtës së pronësisë, dhe e njëjta marrëveshje ka fuqinë e titullit përmbarues.

A r s y e t i m

Paditësi, nëpërmjet të autorizuarës së tij, ka parashtruar padi në Gjykatën Themelore në Pejë, me datë 24.04.2023 kundër të paditurit H.A., baza juridike vërtetim i të drejtës së pronësisë.

Në qendrën e ndërmjetësimit kjo lëndë është referuar me datë 27.02.2024.

Qendra për Ndërmjetësimin, e ka njoftuar gjykatën se me datë 27.02.2024 palët ndërgjyqëse nëpërmjet të autorizuarve të tyre, kanë arritur marrëveshje për këtë çështje kontestimore, duke ia dorëzuar gjykatës marrëveshjen e lidhur në mes tyre.

Gjykata duke ju referuar të cekurave më lartë e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 3.3, 411 dhe 426 të LPK, e lidhur me nenin 3, 4, 10 dhe 15 Ligjit për Ndërmjetësim me nr.06/L-009, i cili ka hyrë në fuqi me datën 28.07.2018, pas shqyrtimit të njëjtës me datën 29.05.2024, ka ardhur në përfundim se marrëveshja jashtëgjyqësore duhet të aprovohet, pasi plotëson të gjitha kushtet ligjore dhe e njëjta është dokument përmbarimor, pra paraqet titullit përmbarues.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.1709/23, me datë 29.05.2024

Gjyqtarja,
Rajmonda Kurteshi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankimi.